

Fillimi > -Kronikë

Video/ Zbardhet plagosja e 25-vjeçarit në Kurbin, policia sekuestron kallashnikov, drogë e tritol, në pranga daja i autorit

15 Gusht, 2021 13:10



Madhësia e tekstit: - +

Policia e Kurbinit ka zbardhur ngjarjen e ndodhur një ditë më parë, ku u plagos me armë zjarri 25-vjeçari E.P(T)

Uniformat blu kanë gjetur dhe sekuestruar armën e zjarrit kallashnikov, me të cilën dyshohet se autori kreu krimin.

Bashkë me armën e dyshuar të krimit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në banesën e dajës së autorit, tritol, kapsolla detonatore, një tjetër armë zjarri pushkë, municion luftarak, lëndë narkotike, doreza, maskë e sende të tjera të kundraligjshme.

Gjatë aksionit, ka rënë në pranga daja i autorit, 52-vjeçari Agron Koçi, ndërsa vijon puna për kapjen e autorit të dyshuar shtetasit Kadri Kurtaj.

Njoftimi i policisë:

Në vijim të punës për dokumentimin e plotë të ngjarjes dhe kapjen e autorit, të plagosjes me armë zjarri të 25-vjeçarit, ndodhur ditën e djeshme në qytetin e Laçit, ku falë veprimeve të shpejta hetimore, shërbimet e Policisë Kurbin, bënë të mundur identifikimin dhe shpalljen në kërkim të autorit të dyshuar të kësaj ngjarje shtetasit Kadri Kurtaj (Imeri), shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontrolle të pandërprera në banesa dhe ambjente në të cilat kishin informacion që mund të fshihej autori i plagosjes së shtetasit E.P(T).

Gjatë kontrolleve të ushtruara në banesën e dajës se autorit të dyshuar shtetasit Agron Koçi, shërbimet e Policisë kanë gjetur armen e zjarrit tip automatik me krehër me 28 fishekë, me të cilën dyshohet së është plagosur shtetasi E.P(T).

Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në banesë janë gjetur dhe një armë tjetër zjarri e llojit pushkë , 8 kallëpe me lëndë plasëse tritol, fitil zjarrpërcjellës, 70 kapsolla detonatore dhe 1.3 kg lëndë narkotike e dyshuar cannabis sativa, të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve, specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Kurbin bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit: Agron Koçi, 52 vjeç, banues në Kurbin ,për veprat penale ” Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit dhe lëndëve shpërthyesë” , “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe ” Përkrahja e autorit të krimit”.

Nga veprimet hetimore rezultoi së shtetasi Kadri Kurtaj(Imeri), pasi ka plagosur shtetasin E.P(T) , për motive të dobëta është larguar nga vendngjarja për në banesën e shtetasit Agron Koçi, (dajës së tij), i cili e ka ndihmuar për të fshehur armën e zjarrit automatik dhe me pas të largohej.

Shërbimet e Policisë vijnë punën intensive për kapjen dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të autorit të dyshuar shtetasit Kadri Kurtaj.

Materialet hetimore u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arrestim Kurbin plagosje

TË NGJASHME

U kap me 50 kg marijuanë dhe hashash çokollate në Igumenicë, identifikohet shqiptari i arrestuar (EMRI)

21 Gusht, 2021

Arrestohet në Durrës maqedonasi i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pritët ekstradimi drejt vendit fqinj

21 Gusht, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Përfshihet nga flakët makina në ecje në tunelin Tiranë-Elbasan, shpëton mrekullisht shoferi

21 Gusht, 2021

Zjarr i madh në afërsi të fshatrave turistikë në Qerret të Kavajës, zjarrfikëset në vendngjarje (FOTO+VIDEO)

21 Gusht, 2021

U gjet i ekzekutuar në makinë në Babicë të Vlorës, ja kush është viktima (FOTO)

21 Gusht, 2021

Aksidenti i trefishtë në Mamurras, tre të plagosur. Çfarë thotë policia

21 Gusht, 2021


Të dehur në timon dhe me shpejtësi "skëterrë", Policia ndëshkon shoferët e pabindur: 11 të arrestuar, pezullohen patentat e vendosen mijëra gjoba

21 Gusht, 2021

Drogë dhe mijëra euro, karabinierët i vënë prangat banakieres shqiptare

21 Gusht, 2021

KATEGORIA VIDEO



Elektrizohet Korça në natën e katërt të festës së birrës, vëllezërit Prifti dhurojnë spektakël në qytetin e serenatave

21 Gusht, 2021

Mes muzikës dhe birrës së mirë, qytetarët: Kemi arritur nga Selaniku enkas për festën në Korçë

21 Gusht, 2021

Atmosfera në Korçë, festa e birrës premton surpriza, gazetarja: Fluks jashtëzakonisht i madh turistësh

21 Gusht, 2021

"S'ka kuptim festa pa birrën Korça" / Qytetarët të mahnitur nga organizimi: Fantastike, keqardhje që nuk kemi ardhur më parë

21 Gusht, 2021

Turistët "pushtojnë" Korçën: Kjo festë na mbledh nga të katër anët e botës

21 Gusht, 2021

Pelegrinazhi në malin e Tomorrit, Ferdinand Samarxhi: Mbi 350 mijë qytetarë nga e gjithë bota i janë bashkuar festës

21 Gusht, 2021

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

